



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ___/___/2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Dt. 30.04.2020

Për: Operatori Ekonomik “Almedikal” sh.p.k. me Nipt.K21511002I

Adresa: Rruga Konferenca e Pezës, Banesa Nr.1, ish Magazinat e ESKUT, Tiranë.

* * *

Procedura e prokurimit: Referuar Urdhërit të Prokurimit Nr. 45 datë 13.11.2019 me objekt: “Blerje peshore elektronike”, me fond limit 3.175.000 (tre milion e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) Lekë pa TVSH, të vëna në dispozicion nga të ardhurat e Shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a., me procedurë “Kërkesë për propozim”, me mjete elektronike e cila u zhvillua më datë 24.02.2020, ora 10:00. [Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor]

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-43803-11-18-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Blerje peshore elektronike

Fondi Limit: 3.175.000 (tre milion e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) Lekë pa TVSH

Burimi i financimit: Financuar nga të ardhurat e shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme;

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 24.02.2020, ora 10:00

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *Datë 25.11.2019* [47]

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “**Tunamar**” sh.p.k. me NUIS L42610208C, me oferte ekonomike 2,294,000 (dy milion e dyqind e nëntëdhjetë e katë mijë) lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik “**Luar Bros**” sh.p.k., me Nipt L72322004M me oferte ekonomike 2,698,000 (dy milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH

3. Operatori Ekonomik “**Farma Net Albania**” sh.p.k me Nipt.k 92201080V me ofertë 2.777.400,00 (dy milion e shtatëqind e shtatëdhjet e shtatë mijë e katërqind) lekë pa TVSH.

4. Operatori Ekonomik “**Almedikal**” sh.p.k. me Nipt.K21511002I me ofertë ekonomike 3.104.000 (tre milion e njëqind e katër mijë) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “**Krijon**” sh.p.k. nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe dokumentat ligjore të përcaktuara në DST.

Janë skualifikuar operatorët ekonomik të mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “**Tunamar**” sh.p.k.
2. Operatori ekonomik “**Luar Bros**” sh.p.k.,
3. Operatori Ekonomik “**Farma Net Albania**” sh.p.k
5. Operatori ekonomik “**Krijon**” sh.p.k.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “Tunamar” sh.p.k.

▪ Nuk plotesohet pika e **Kritereve të veçanta te Kualifikimit, pika b, ku konkretisht:** Deklarata për paraqitje oferte te pamvarur, sipas shtojcës 2/1.

Ne tabelen e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “**Tunamar**” sh.p.k. ne zerin ‘**Afati Kohor**’ operatori ekonomik ka caktuar afatin 150 ditë për dorzimin e mallit nga data e nenshkrimit te kontrates mes paleve dhe jo 45 ditë sipas dokumentave Standarte te tenderit te përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

2. Operatori ekonomik “Luar Bros-” sh.p.k.,

Nuk plotesohet pika **2.1.1 e Kritereve të veçanta te Kualifikimit, ku konkretisht:** Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore të tre viteve të fundit 2016, 2017, 2018. Operatori ekonomik Luar Bros ka paraqitur ne sistem xhiron e dy viteve te fundit 2017 dhe 2018, ku kjo pike është vendosur nga autoriteti kontraktor pikerisht per te vertetura performancen financiare te kompanise.

▪ Nuk plotesohet pika **2.2 e Kritereve të veçanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik pika 2.2.5 ku konkretisht:** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Katalog prodhuesi të mallit që ofrohet, të vulosur nga operatori ekonomik ku të jetë përcaktuar malli që ofrohet, si dhe të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe;

▪ Operatori ekonomik Luar Bros sh.p.k nepërmjet katalogeve dhe certifikatave të ngarkuara në sistem KVO-ja nuk ka arritur të verifikoj te dhenat teknike te kërkuara ne specifikimet teknike për peshoret elektronike te 5 kg dhe 50 kg.

Konkretisht për peshoret elektronike 5 kg nuk identifikohet;

- **Bateria e karikueshme** te mbajne peshoren ne pune ≥ 24 ore
- **Numrat ne ekran** te jene jo me pak se 25mm, ne funksion te leximit nga distanca

Konkretisht për peshoret elektronike 50 kg nuk identifikohet;

- **Përmasat e indikatorit:** 200mm – 220 mm X 100mm – 150mm X 50 – 80mm;
- **Bateria e karikueshme** të të mbajnë peshoren në punë ≥ 24 orë;
- **Numrat ne ekran** te jene jo me pak se 25mm, ne funksion te leximit nga distanca

3. Operatori Ekonomik “Farma Net Albania” sh.p.k

- Nuk plotësohet pika 2.2 e Kriterëve të veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik pika 2.2.10 ku konkretisht: Në orën e përcaktuar në njoftimin e kontratës për hapjen e ofertave, Operatoret Ekonomik duhet të paraqesin dorazi, përpara Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO), **mostra (kampionë)**, të 1 (një) peshoreje elektronike 5 kg dhe 1 (një) peshoreje elektronike 50kg, të cilat duhet të jenë sipas të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara. Mos paraqitja e mostrave në afatin e përcaktuar dhe jo sipas specifikimeve teknike është kusht për skualifikim.

- Operatori ekonomik “Farma Net Albania” sh.p.k. në të dyja artikujt e sipërcituar për peshoret elektronike 5 kg dhe 50 kg është kërkuar të jenë të përfshira në paketim kabllot lidhëse përkatëse të cilat lidhen me kompjuterin, por ky operator nuk i ka paraqitur këto kabllot në dorëzimin e mostrave për të dyja peshoret elektronike 5kg dhe 50 kg. Ky fakt u konstatua dhe nga operatoret e tjera në evidentimin e mostrave.

- Nuk plotësohet pika 2.2 e Kriterëve të veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik pika 2.2.5 ku konkretisht: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Katalog prodhuesi të mallit që ofrohet, të vëlosur nga operatori ekonomik ku të jetë përcaktuar malli që ofrohet, si dhe të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe;

- Operatori ekonomik “Farma Net Albania” sh.p.k nëpërmjet katalogeve dhe certifikatave të ngarkuara në sistemin KVO-ja nuk ka arritur të verifikoj të dhënat teknike të kërkuara në specifikimet teknike për peshoret elektronike të 5 kg dhe 50 kg.

Konkretisht për peshoret elektronike 5 kg nuk identifikohet;

Modeli i paraqitur nuk plotëson të dhënat teknike:

- **Ndërfaqet e komunikimit:** RS232 Standard ose USB 1.1/2.0. Të jenë të përfshira në paketim kabllot lidhëse përkatës USB 1.1/2.0 ose serial RS232 të cilat transferojnë informacionin e peshës së matur automatikisht në PC nëpërmjet protokollit SERIAL në rastin RS232 ose emulim të portës seriale në rastin e USB1.1/2.0; Në modelin e ofruar vihet re qarte se nuk ka portë lidhëse për ndërfaqen e komunikimit për asnjë nga alternativat e kërkuara në DST-të në funksionalitetin e marrjes së të dhënave.

Konkretisht për peshoret elektronike 50 kg nuk identifikohet;

- **Përmasat e indikatorit:** 200mm – 220 mm X 100mm – 150mm X 50 – 80mm;
- **Numrat në ekran** të jenë jo më pak se 25mm, në funksion të leximit nga distance

- **Ekрани:** Të shfaqë peshën në kohë reale dhe ekрани të jetë i tipit LCD/LED. Numrat në ekran jenë jo më pak se 25mm, në funksion të leximit nga distanca; Operatori ekonomik ka paraqitur modelin CFS 50K-3 për peshoren elektronike 50kg dhe ka markuar në katalogun përkatës lartësi dixhitale 20mm.

4. Operatori ekonomik “Krijon ” sh.p.k. nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe dokumentat ligjore të përcaktuara në DST.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatori Ekonomik “**Almedikal**” sh.p.k. me Nipt.K21511002I se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 3.104.000 (tre milion e njëqind e katër mijë) lekë pa TVSH., pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoriteti Kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a., Adresa: Rr, “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kjo procedurë prokurimi anulohet pasi nuk ka operator ekonomik të klasifikuar vijues siç parashikohet në nenet 24 dhe 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 10.03.2020.

Ankesa: Ka patur.

Pranë Autoritetit Kontraktor është paraqitur ankesa si më poshtë vijon:

Me datë 24.03.2020, është paraqitur ankesë nga Operatori Ekonomik “**Tunamar**” sh.p.k. me nr. 2999/21 prot.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Posta Shqiptare sh.a., brenda afateve ligjore është trajtuar ankesa, Operatorit Ankimues i është kthyer përgjigje me nr. 2999/22 prot, datë 27.03.2020 Operatori Ekonomik “**Tunamar**” sh.p.k. me NUIS L42610208C është ankuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit të sipërpërmendur e cila me Vendimin Nr. 136/2020 Prot, datë 16.04.2020 ka vendosur të mos pranojë ankesën e paraqitura nga Operatori Ekonomik duke lejuar në këtë mënyrë AK Posta Shqiptare sh.a të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Laert Duraj